

## KODI I ETIKES DHE I SJELLJES

## 1. PARATHENIE

Kodi i Sjelljes dhe i Etikës ka si funksion primar të bëjë të njohur brenda organizmit dhe të gjitha palëve të interesuara, vlerat dhe parimet kryesore që udhëheqin aktivitetin e **WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN'**. Ky kod ka si objektiv që të tregojë sjelljen individuale me qëllim që të paraqitet një imazhi i korrektesisë të organizmit dhe prestigjin e reputacionin që është gjithmonë paresore në shoqëri. Gjithashtu ky kod vendoset për të ndikuar në politikën që zbatohet në proceset kryesore të aktivitetit, në frymën e përmirësimit të vazhdueshëm, duke implementuar një sistem menaxhimi dhe kontrolli të brendshëm.

Një sistem i përgjithshëm i vlerave dhe parimeve duhet të konceptohet dhe të ndahet me çdo punonjës, në të gjitha nivelet, në mënyrë që ne mund të themi se mbi një sistem të tillë është e bazuar gjithë veprimtaria kompanisë. Sistemi parashikon që çdo drejtues, punonjës ose bashkëpunëtorë i grupit, të jenë vazhdimisht të vetëdijshëm për përgjegjësinë e tij për të respektuar parimet e Kodit, në zbatimin e aktiviteteve të tij dhe faktin se kjo kërkesë përbën një nga pjesët thelbësore të detyrave të tyre kontraktuale.

Moszbatimi i parimeve dhe shkeljet e rregullave të Kodit të Etikës do të trajtohen si keqdashje dhe do të jenë të ndjekura nga sanksionet e miratuara nga WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN', në përputhje me ligjet dhe mosmarrëveshjet kontraktuale. Kodi është një pjesë integrale e "Modeli i organizimit, menaxhimit dhe kontrollit"

## 1. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT E PERBASHKETA

### 2.1 Misioni ynë

#### Ne ofrojmë shërbime për Përmirësimin

Qëllimi i aktivitetit tonë është që të ofrojmë për operatorët ekonomik dhe institucionale shërbimet e:

- Certifikimi
- Verifikimi
- Kontrolli
- Mbeshtetje

që synojnë përmirësimin e proceseve dhe shërbimeve të tyre, sigurisë dhe cilësinë e produkteve që ato ofrojnë.

#### Promovojmë Cilësinë

Ne duam të udhëheqim në zhvillimin e nivelit të cilësisë së tregut, duke promovuar se vetëdija e realizimit të masave për të mbrojtur sigurinë dhe mjedisin në përgjithësi dhe vëmendja ndaj cilësisë janë qëndrime të cilat ofrojnë përfitime dhe rritin vlerën e shoqërive që i ndjekin .

#### Kontribuojmë për të rritur standardet

Puna jonë kontribuon në mirëqenien e shoqërisë sepse ndihmon në përmirësimin cilësinë dhe sigurinë e jetës njerëzore dhe ruajtjen e mjedisit për brezat e ardhshëm. Për këtë arsye, ne ju ofrojmë organizatat dhe institucionet përgjegjëse për vendosjen e normave dhe standardeve të cilësisë dhe sigurisë dhe kontributin tonë.

#### Ne jemi një kompani nderkombetare

Identiteti ynë është Shqiptar. Ne kemi një reputacion të njohur për ekspertizën tonë teknike dhe shkencore dhe aftësinë tonë për të zgjidhur problemet me disponueshmërinë, zgjuarsin, kreativitet dhe stil, në respekt me rregullat dhe ligjet.

Ne impenjohemi për të dhënë personelit tonë një impenjim produktiv dhe një perspektive stabiliteti dhe të sigurte.

Investojmë në zhvillimin e tyre dhe ngritjen e tyre profesionale, duke ju vlerësuar kompetencat teknike, kapacitetet për të zgjidhur problemet dhe për të kuptuar nevojat e klientit, autonomine, në respekt me vlerat e WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN'.

## 2.2 VIZIONI YNE

### **Ne jemi një organizem multibusiness, të vetme dhe të integruar**

Ne jemi një organizem, të artikuluar dhe të integruar, me një trashëgimi të çmuar të përbashkët bazuar në:

- mbi ekspertizën tonë teknike dhe profesionale
- tek klientët tanë
- vlerën e markës tonë

Zgjerojme aktivitetin tonë, duke shfrytëzuar kryesisht energjite tona të brendshme.

### **Ne jemi një organizem autonom dhe i pavarur**

Ne jemi një organizem i pavarur, i cili vepron lirshëm në treg vetëm ose nëpërmjet raporteve, marrëveshjeve, partneriteteve dhe sinergji me organizatat e tjera për zhvillimin dhe inovacionin e shërbimeve.

### **Ne punojmë me Liderat**

Ne favorizojmë zgjedhjen e konsumatorëve inovator dhe serioze, që kuptojnë objektivat tona për mbrojtjen e cilësisë dhe sigurisë dhe për të krijuar me ta partneritete për rritjen e standardeve të cilësisë në tregjet e tyre përkatëse.

### **Ndjekja e Rentabilitetit në kohë**

Objektivi ynë është që të prodhojë rezultate që do të gjenerojë një kthim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në kohë, në sajë të se cilës është e mundur:

- rritje të kapitalit dhe punës
- financimin e zhvillimit të organizmit
- mbrojtjen e autonomisë dhe pavarësisë tonë
- të mundësojnë që të përmbushim rolin tonë

Duhet të përpiqemi për të arritur një fitim të drejtë, dhe të krahasojmë rezultatet tona me ato të marra nga kompanitë që ofrojnë shërbime, këshilla teknike dhe që vepron në tregjet e njëjta.

### **Ndjekim një rritje të fokusuar.**

Ne duam të ofrojmë shërbime që japin një vlerë të shtuar për klientët tanë dhe të gjenerojë hapsira të përshtatshme për organizmin tonë: Madhësia e rritjes së vëllimit të shitjeve nuk përfaqëson objektivin tonë kryesor.

Mbi zhvillimin kemi një qasje selektive dhe të fokusuar: investojmë në ato tregje apo segmente ku ne mund të gjenerojmë në kohë të arsyeshme dhe më një nivel risku të pranueshëm, rezultate që kontribuojnë për rentabilitetin e kompanisë tonë me kalimin e kohës.

### **Duam të diferencohemi për Cilësinë e shërbimit**

Diferencimi ynë konkurrues është cilësia e shërbimit tonë, e cila karakterizohet;

- ne kerkesat për kompetenca
- ne marrëdhëniet me klientin
- ne aftësinë tonë për të kuptuar nevojat
- ne integritetin e punës sonë
- ne kohën tonë për të dhënë përgjigje.

## 2.3 VLERAT TONA

### **Profesionalizem dhe integritet**

Konsiderojmë, integritetin si një element thelbësor i profesionalizmit tonë, të vetdijshëm për kontributin që secili prej nesh duhet të ketë për zhvillimin e nivelit të cilësisë së tregut.

### **Përgjegjësia**

Në çdo nivel të organizimit, marrim përgjegjësinë për cilësinë e punës së kryer nga ne dhe bashkëpunëtorët tanë dhe jemi të vetëdijshëm për ndikimin e aktiviteteve tona tek klienti final.

### **Rëndësinë e personelit.**

Ne e njohim rëndësinë e njerëzve që punojnë në organizatën tonë, dhe respektojmë diversitetin dhe favorizojmë zhvillimin dhe mirekuptimin.

Përkushtohemi për të krijuar një atmosferë pozitive, të hapur dhe të qete brenda organizmit, në mënyrë gjithkush të ndihet i motivuar dhe mund të kontribuojnë për të përmirësuar aktivitetin e organizmit.

### **Te vetedijshem per Kostot**

Punojmë të gjithë me kujdes të vazhdueshme dhe me përgjegjësi për shpenzimet dhe defektet, për ruajtjen e burimeve financiare drejtuar përmirësimit të aftësive konkurruese të organizmit dhe përmirësimit të kapaciteteve për të investuar në zhvillimin tonë.

### **Integritet dhe Puna ne grup**

Integriteti ndërmjet funksioneve, aktiviteteve dhe sektorëve të biznesit është një kusht për arritjen e objektivave tona.

Ne e njohim rëndësinë e punës si ekip, mbështetemi me besim në kompetencën e kolegeve tane dhe vendosim të tonen në dispozicion të të gjithëve.

### **Partneriteti me Klientin**

Lidhim me klientët tanë marrëdhënie të ngushta të bazuar në besim dhe në objektiva të përbashkëta, të vetëdijshëm që suksesi i klientëve tanë do të favorizojë të suksessin tonë. Nxisim dhe marrim "feed back" mbi aktivitetet tona për të përmirësuar cilësinë e shërbimit tonë dhe produktet tona.

### **Respektimi rigoroz i rregullave të përbashkëta**

Kërkojmë sjellje në përputhje me ligjin, rregullave dhe standardeve të vendosura nga kompania për të siguruar imazhin tonë, reputacionin tonë dhe cilësinë e shërbimit tonë.

## **3 PARIMET E APLIKIMIT**

### **3.1 Pajtueshmëria me ligjin**

Gjithë personeli i WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' duhet të respektojë rregulloret dhe standartet në fuqi në vendet, fushat dhe aktivitetet ku ajo vepron në emër të WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN', Kodin i Etikës dhe rregullat tjera.

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' impenjohet të respektojë rregulloret dhe standartet në fuqi në vendet ku ajo vepron, Kodi i Etikës dhe rregullat tjera të brendshme.

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' impenjohet për të shpërndarë, sidomos me ata që punojnë në zonat dhe poste më liri operationale dhe me përgjegjësi për personelin, që në baze të udhëzimeve dhe rregulloreve të përgjithshme, vetëdijet se sjellja e paligjshme ose të paskrupullt dhe mënyrë jokorrekte mund të shkaktojnë dëme serioze të imazhit dhe reputacionit të organizmit, si dhe funksioneve dhe pasurive të organizmit.

### **3.2 Besimi në marrëdhëniet me palët të interesuara**

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' konfirmon vullnetin e saj për të zhvilluar marrëdhëniet e besimit me aktorët e vet, apo atyre personave, subjekteve, institucioneve mbështetja e të cilëve është e nevojshme për të arritur misionin e organizmit.

### 3.3 Mbrojtja dhe Shfrytëzimi i Burimeve Njerëzore

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' ndjek ne konfront me personelin e saj nje politikë manaxhimi te bazuar në kriteret e sjelljes transparente, të drejtë, te sigurtë dhe respekti reciprok.

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' është e angazhuar fort për të rritur kapacitetet dhe aftësitë e stafit të saj, e vetdishme se profesionalizmin dhe angazhimin i personelit janë kushte thelbësore për arritjen e objektivave te organizmit.

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' nenvizon, ne respekt për ligjshmërinë, rëndësinë e mbrojtjes së pasurive të organizmit dhe çdo pasuri tjetër qe organizmi nga keqperdor, te paautorizuar, nga neglizhenca apo keq veprimet që mund të shkaktojë dëme ose humbje.

### 3.4 Ruajtjen e informacionit te shoqerise

Pasuria e informacionit të organizmit duhet te jete i lejushem vetëm për personat e autorizuar dhe të mbrojtura nga shperndarja dhe perdorime të parregullta ose të paligjshme. Informacioni qe nuk mund te publikohet, mbahen te rezervuara, në përputhje me rregulloret aktuale.

### 3.5 Mbajtje pozitive te marrëdhënieve me jashte

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' bashkpunon faktikisht, dhe dëshirojn të vazhdojnë ta bëjnë në mënyra dhe në rritje, me Administratën dhe institucione publike shqiptare, me organizatat ndërqeveritare, me autoritetet, shoqatat , agjensitë shqiptare ose të huaj.

Organizmi veprojn me vetedije qe paanësina është një nga kërkesat kryesore për besueshmërinë e certifikimit, të cilat janë një prej pasurive kryesore të WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN', dhe se vendimet për certifikim janë të bazuara në element objektive te konformitetit dhe nuk janë ndikuar nga interesa apo pale te tjera. Për këtë qëllim, organizmi, kur ndermerr dhe organizon aktivitetet e tij, edhe pse në pajtim me mandatet statutore dhe ligjet, duhet të marrë masa për të siguruar që aktivitetet e tilla nuk mund të ndikohen nga risku i konflikteve te interesit me veprimtarinë e certifikimit.

## 4. Normat standarde te sjelljes

### 4.1 Raportet e brendshme

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' ndjek objektivat e rritjes dhe të zhvillimit, jo vetëm përmes rritjes në cilësi dhe sasi të aktivitetit te saj, por edhe nëpërmjet iniciativave të ndryshme të ndërmarra nga aktorë të tjerë në treg. Këto iniciativa mund të ndermerren, edhe me formën e marrëveshjeve përbashkëta me partnerë të tjerë, nga tregtia apo investimet në shoqëritë ku mund te kete ortake dhe partner, marrëveshje operative tregtare apo aleancave.

Të gjithë personeli i përfshirë në mënyra të ndryshme dhe me përgjegjësi të ndryshme në këto aktivitete duhet të zhvillojë sjelljen e tyre dhe rrjedhën e veprimit për kriteret e korrektesise dhe parimeve e kodit te etikes dhe selljes.

Në mënyrë të veçantë, vazhdimisht të vetëdijshëm se çdo shkelje të parimeve të Kodit të Etikës, do të regjistrohen ashtu sic eshte shprehur ne kapitujt lidhur me standardet dhe sistemin e kontrollit, të gjithë personat janë të detyruar të:

- të sigurohen që partnerët ose anëtarët e tjerë te gëzojnë reputacion të mirë, dhe nuk janë të përfshirë në aktivitete jo te lejueshme, qe ata veprojnë në përputhje me parimet e ndershmërisë dhe etikës përgjithësisht i pranuar
- te kushtohet e gjithë vemendja me qellim qe veprime te mundshme te pershkuara me siper nuk sjellin risqe te pakesimit te aktivitetit dhe pasurise se WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN'

- te veprojnë ne respekt me legjislacionin dhe me transparencë maksimale, duke mos ndjekur përfundimin e marrëveshjeve me çdo kusht për hir të interesit personal, imazhit apo duke favorizuar padrejtësisht interesat e një ose më shumë palëve të interesuara
- të inkurajojë ne cdo menyre tek partnerët parim etik te reciprocitetit dhe të bashkëpunimit

#### **4.1.1 Personeli Ekskluzive**

Në fushën e të drejtave të njeriut, mjedisi dhe puna e WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' bazohen në Parimet e kompaktit Global të sponsorizuar nga Kombet e Bashkuara.

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' impenjohet te mos përdorë, dhe as te favorizojë, punën e detyruar ose punën e fëmijëve, kontrastimin me çdo mjet ngacmimet dhe molestite, abuzime, diskriminimin e çfarëdo lloji. Gjithashtu impenjohet për të garantuar sigurinë në vendet e punës, respektimin dhe të drejtën e organizimit ne shoqata dhe te kontrave kolektive, shpërndarjen e pagave, respektimin e orareve te punës në përputhje me legjislacionin dhe kontratave të brendshme si dhe te shpërndarjen e cmimeve me kriteret te drejta.

#### **4.1.2 Ngritja dhe manaxhimi i raporteve te punësimit**

Marrëdhënieve të punës ne WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' nisin me menyra dhe te kriterëve qe i pergjigjen standardeve , procedurave dhe praktikave te brendshme që lidhen në veçanti:

- përcaktimin e nevojave për futjen e burimeve të reja, të cilat përcaktohen në buxhetin vjetor dhe miratohen në detaje nga drejtuesi.
- procedurat qe perdor shoqeria per perzgjedhjen, në respekt me mundësitë e barabarta për të gjithë personat e interesuar për te punesuar në Kompani, privatësinë dhe pikëpamjet e tyre, duke evituar cdo lloj forme klienteleste ose te favoreve te pajustificueshme.
- marrëdhëniet e punës janë të menaxhuara në përputhje të plotë me ligjet në fuqi, kontratat e punësimit, rregulloreve dhe direktivave në fuqi: nuk është e lejuar ose toleruar asnjë parregullsi ose paligjshmëri te tipit kontraktual, ose të sigurimit në marrëdhëniet e punës.

Duke pasur parasysh stafit si një faktor thelbësor për zhvillimin dhe arritjen e objektivave të kompanisë, WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' është e angazhuar për të vlerësuar aftësitë dhe potencialin e stafit bazuar në kriteret objektive dhe transparente, duke e konsideruar paresore, për avancim të karrierës dhe pagave njohjen e arritjes se rezultateve, te kompetencave dhe aftësitë te shprehura ne kohe.

Në këtë kuptim, merr nje rëndësi të veçantë objektivi i nje sistemi efikas te vleresimit nga ana e drejtuesve kryesor, mbi pikat e forta ose te permirsimit tek personeli, dhe ne favorizimin e ngritjes profesionale individuale.

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' është e angazhuar në promovimin e kushteve dhe mjediset e punës ne te cilat personeli mund të punojë me të kushteve të përshtatshme te qetesise, prosperitetit dhe sigurisë.

Mbrojtja e privasise është siguruar në përputhje me legjislacionin aktual, ne baze te te cilave kerkohen, trajtohen dhe ruhen vetem informacione lidhur me realizimin korrekt te raporteve te punes.

Eshte e ndaluar cdo komunikim/shperndarje te te dhenave personale pa marre paraprakisht autorizimin e personit. Nuk lejohet kërkesa për informacion që lidhet me jetën private të individëve.

### 4.1.3 Detyrat e personelit

Çdo person, në ushtrimin e veprimtarisë së tij, duhet të mbajë një sjellje në përputhje me ligjet dhe rregulloret e tjera në vendet ku ajo vepron, si dhe në përputhje me politikën e kompanisë.

Stafi duhet të ofrojë shërbime paraqitje në punë në nivele të përshtatshme, me angazhimin për përmirësim të vazhdueshëm; në marrëdhëniet me personelin, me kolegët dhe eprorët do të mbajë dhe evidencat e një shpirti bashkpunimi dhe korrektesie. Çdo person i punësuar nga kompania duhet të respektojë pasurinë WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN'; përdorimi i tyre duhet të jetë funksional dhe vetëm për të kryer aktivitetin zyrtar, të shmangë përdorimin e pahijshëm, mashtrues ose në kundërshtim me interesin e kompanisë.

Përdorimi i sistemeve të informacionit duhet të përputhet me sistemin e sigurisë së brendshme; nuk është e lejuar përdorimi i tyre për qëllime të tjera nga ai punësimi.

Informacionet e marra gjatë aktivitetit të tyre në punë duhet të mbeten konfidencial, përdoret vetëm për ushtrimin e aktivitetit të tij, dhe të menaxhohen në mënyrë që të sigurohet integriteti dhe siguria.

Çdo person i punësuar nga WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' duhet të shmangë çdo situatë të konfliktit të interesit mes situatave në të cilën është dhe aktiviteti personal ose familjar dhe të aktivitetit të shërbimit, të cilët mund të kompromentohen, paansinë dhe integritetin e gjykimit apo të sjelljes.

Drejtpesërisht e WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' nuk duhet keqpërdorimi i pozitës së tyre, rolin apo kompetencat brenda shërbimit për të ushtruar presion të cfarëdo lloji mbi stafin dhe për të influencuar, në një mënyrë dhe për qëllime të papërshtatshme, realizimin e aktiviteteve të caktuara.

Gjithkush duhet të refuzojë çdo presion të parregullt në kryerjen e aktivitetit të tij. Në rastin në të cilin dikush presion ose merr propozime të cilat mund të ndikojnë në realizimin e objektivave dhe në paansinë, duhet të informojë eprorin e tij dhe organizmin.

Çdo person i punësuar nga WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' duhet të refuzojë trajtimin e favorshëm apo përfitime të tjera, dhurata ose akteve të shkojnë përtej dimensionit mikpritjes; në të gjithë situatat në të cilat tejkalohet limiti, ose ekziston dyshimi, vetë personi duhet të informojë eprorin e tij për marrjen e një vendimi sa më të mirë.

## 4.2 MARRËDHËNIET E JASHTME

### 4.2.1 Klientët

Në marrëdhëniet me konsumatorët, është e rëndësishme respektimi i legjislacionit dhe rregullave në fuqi, veçanërisht ato të ngritura në mbikqyrjen e konkurrencës së tregut, organizmi WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN', i vetëdijshëm që biznesi është shtyre nga konsumatorët dhe nga nevojat për të ruajtur marrëdhënie të besimit dhe respektit reciprok dhe të konsideracionit, duke synuar në përmbushjen e nevojave të tyre duke u ofruar shërbime me cilësi të lartë në kushtet e konkurrencës, duke shmangur çdo sjellje diskriminuese ose të pahijshme.

Në këtë kuptim, merr një rëndësi të madhe një sjellje ndaj klienteve, bashkpunuese dhe efikase, ngritja e një sistemi komunikimi të hapur, në pajtim të qartë dhe të plotë me angazhimet dhe detyrimet kontraktuale.

Parimet që duhet ndjekur në marrëdhëniet me klientët nga të gjithë stafi i WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' janë të profesionalizmit, efikasitetit, saktësisë, disponueshmërisë dhe mirësjelljes.

Nuk lejohen, për shembull, modifikime në kushtet e kontratës ose realizimi i aktiviteteve, pa pëlqimin paraprak të klientit. Është e ndaluar të ofrohet ose realizohet bashkpunorve të klienteve (perfaqësuesve apo vertesve), dhurata ose të tjera me qëllim që të sigurohen avantazhe personale ose për organizmin. Aktiviteti i certifikimit dhe i personelit të angazhuar

në të duhet të jete në atë mënyrë që te siguroje objektivitet dhe paanësi. Respektimi i ketij parim duhet të garantohet edhe në aktivitetin e promovimit të shërbimit të certifikimit.

#### **4.2.2 Marrëdhënie me Furnizuesit**

Për përzgjedhjen e furnizuesve dhe blerjen e mallrave dhe shërbimeve janë percaktuar funksione të veçanta të shoqërisë, dhe ju kërkohet të veprojnë në bazë të vlerësimeve objektive të cilësisë, çmimeve, besueshmërisë, konkurrencës, dhe menyrave të realizimit të shërbimit.

Për menaxhimin e marrëdhënieve me furnizuesit ju referohemi udhëzimeve të percaktuara për marrëdhëniet me klientet.

#### **4.2.3 Marrëdhëniet me Personelin jo Exclusive**

Personeli jo ekskluziv, (profesionistë, teknikë dhe konsulentët) është kryesisht i përbërë nga një numër i konsiderueshëm personash të cilët, edhe pse jo të lidhur me një marrëdhënie të veçantë pune, punojnë duke ndjekur interesat e organizmit, që operojnë në sektorë të ndryshëm.

Personeli jo ekskluziv duhet të respektojë parimet e Kodit të Etikës dhe Sjelljes; e njëjta është edhe për personelin ekskluziv në fazën e përzgjedhjes dhe emërimit të personelit jo ekskluziv. Personeli jo ekskluziv para se të marrë një detyrë për një organizatë duhet të informojnë drejtuesin e organizmit me të cilin ai koordinon realizimin e veprimtarisë së tij profesionale, mbi çdo marrëdhënie të mundshme që ekziston ose ka ekzistuar në 3 vitet e fundit me shoqërinë.

Personeli jo ekskluziv, në rast kur ofron ndarazi dhe në mënyrë autonome shërbime konsulence mbi bazën e të njëjtave standarte dhe rregulash objekt të certifikimit nga ana e WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN', duhet të qartësojë që kjo është plotësisht e ndarë nga certifikimet e WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' dhe se aktiviteti i tij i konsulencës nuk duhet të kuptohet në asnjë mënyrë si një mjet që lehtëson arritjen e certifikimit nga ana e WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN'. Për menaxhimin e marrëdhënieve me personelin jo-ekskluziv, zbatohen parimet e percaktuara për marrëdhëniet me klientet.

#### **4.2.4 Tregu**

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' konsideron konkurrencën në treg, ku karakterizohet nga parimet e drejta, ndershmërisë dhe konkurrencë, si një faktor në përmirësimin e "produkteve dhe shërbimeve."

#### **4.2.5 Komuniteti**

Në komponentët e saj të ndryshme operacionale, misioni i WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN', siç është vënë në dijeni, është që të ofrojë tregut shërbime të certifikimit ose vlefshmerie mbi përputhjen e sistemeve të perbera me kërkesat e percaktuara nga standarte të brendshme ose të jashtme – në të cilin numri i kompleksitetit është në fazën e rritjes, të lishuar me rritjen e nevojave në kontekstin shoqëror të sigurisë, cilësisë, etikës – me qëllim që të tutelojë një rrezik që të bëjë, përveç se me klientin, edhe me mjedisin dhe komunitetin.

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' duhet të jetë vazhdimisht e vetëdijshme për rolin e saj dhe ndikimin që mund të ushtrojë veprimtaria e saj.



#### **4.2.6 Marrëdhëniet me institucionet Publike**

Marrëdhëniet me institucionet publike, shqiptare ose i huaj, duhet të karakterizohet nga një frymë bashkëpunimi, ndershmërie, drejtësie dhe transparencë. Si rrjedhojë WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' shpreh angazhimin e saj për të filluar dhe për të ruajtur format e komunikimit me institucionet ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale, dhe për të përfaqësuar saktësisht interesat e tyre, në menyre koherente dhe të ndershme.

Në marrëdhëniet me të punësuarit e institucioneve publike (përfaqësues, organet e korporatave, punonjësit ose këshilltarë) nuk lejohet sjellje të cilat ju sigurojnë trajtim të favorshëm, duke ofruar shërbime për ata ose të afërmit e tyre apo persona të tjerë lidhur me interesat e tyre, edhe jo ekonomike, para apo dhurata dhe favore të tjera.

#### **4.2.7 Organizatat e palëve të interesuara**

Marrëdhënie me palët e interesuara, politike ose sindikaliste, duhet të karakterizohet nga parimet absolute të pavarësisë dhe transparencës, pa diskriminim apo trajtim të pabarabartë.

Nuk lejohen asnjë formë shoqërie të mbështjese ekonomike ose të natyrave të tjera, as të personave që përfaqësojnë ato. Nuk janë të ndaluara forma transparente të marrëdhënieve me shoqëri të palëve të interesuara, edhe me qëllime ekonomike ose për zhvillimin e aktiviteteve, ose të marrëdhënieve të interesave reciproke, me kusht që të jenë të qarta dhe që tregojnë qëllimin produktiv të WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN'.

#### **4.2.8 Media**

Marrëdhëniet me median janë karakterizuar me paanësi, me një frymë të bashkëpunimit dhe të zbatimit të ligjit e informacionit. Këto raporte janë përgjegjësi e vetme e drejtuesve ose personave të deleguara prej tyre. Nuk u lejohet asnjë bashkëpunëtor të japë për gazetaret ose mjettet e komunikimit, edhe nëse janë kontaktuar, deklarata ose komunikime që kanë të bëjnë me shoqërinë nëq nuk janë të autorizuar.

### **5 Sistemi Kontrollit dhe organet e kontrollit**

WR ERN BERATUNG 'CERT-ERN' ka miratuar një model të menaxhimit me qëllim parandalim të parregullsive që mund të shfaqet tek përfaqësuesit, punonjësit dhe partnerët. Gjithashtu është ngritur një komitet monitorues, i cili duhet të garantojë pavarësisë, paanësi, si dhe kompetencat për qene në gjendje për të ushtruar funksionet e tyre mbikëqyrëse, detyra e të cilit janë si vijon:

- do të sigurojë përputhje me modelin e menaxhimit
- monitorimin e pajtueshmërisë me dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes
- menaxhimin e të gjitha aspekteve të drejtimit dhe zbatimit të Kodit të Etikës, së bashku me ndonjë trajnim të nevojshme në këtë drejtim
- për sinjalet e marra mbi shkeljet të rregullave të përcaktuara të Kodit të Etikës, duhet të sigurojë konfidencialitetin e burimeve të këtyre raporteve
- do të sigurojë përditësimin e Kodit të Etikës